REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA · VLADA · GOVERMENT
MINISTRIA E EKONOMISË
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Njesia Org. / Org. Jedin / Org Unit 0113
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages —
Nr. Prot. / Br. Prot / Prot.No: 2095
Datë: / Datum: / Date: 02.11.26
PRISHTINË/A NO.1

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
HIDRODRINI
SH.A. - PEJË ZYRA QËNDRORE
Nr. 58 Data 28.10.26

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
SH. A.

HIDRODRINI

Zyret qendrore
Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156 30000 Pejë
Telefoni: 039 / 432 355
www.hidrodrini.com

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, 05/L-009 dhe 08/L-276 si dhe në përputhje me Statutin e K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A. Pejë, pas shqyrtimit të Raportit TM3/2026 të K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A. Pejë, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më 28.10.2026, njëzëri, mori këtë:

V E N D I M Nr. 36

I. Aprovohet Raporti TM3/2026 i K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A. Pejë për periudhën raportuese Korrik – Shtator 2026.

II. Konstatohet se Raporti TM3/2026 paraqet gjendjen operative, financiare dhe performancën e ndërmarrjes gjatë periudhës raportuese, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.

A r s y e t i m

Bordi i Drejtorëve shqyrtoi Raportin TM3/2026 të përgatitur nga menaxhmenti i K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A. Pejë, në të cilin paraqiten aktivitetet operative, financiare dhe treguesit e performancës së ndërmarrjes për tremujorin e tretë të vitit 2026.

Pas shqyrtimit të raportit dhe diskutimeve të zhvilluara në mbledhje, Bordi vlerësoi pozitivisht përformancen financiare të ndërmarrjes, duke theksuar rritjen e faturimit krahasuar me vitin paraprak dhe tejkalimin e planifikimit. Në aspektin operativ nuk janë evidentuar ndryshime negative që do të ndikonin në mënyrë përmbajtësore në funksionimin e ndërmarrjes.

Për këto arsye, Bordi i Drejtorëve vendosi aprovimin e Raportit TM3/2026 sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Kryesuese e Bordit të Drejtorëve

Qendresa Kukaj - Prelvukaj

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT HIDRODRINI SH.A. PEJË

Vendimi u dërgohet:

- Bordit të drejtorëve;
- NJPMNP-së;
- Arkivit të NP-së.